



BASE A M/  
7  
Nr. 152  
Data 12.01.2024  
N. J. R.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
DREJTORIA VENDORE KORÇË

Nr. 50/7 Prot.

Korçë, më 10.01.2024

Lënda: Kërkesë për publikim.

**NJËSISË ADMINISTRATIVE POJAN** ✓

Brenda kompetencave institucionale dhe tagrit ligjor të garantuar nga Ligji nr.111/2018 „Për Kadastrën“, Ligjit nr. 20 dt.05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1040/2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë ka miratuar Vendimet për legalizimin e ndërtimeve pa leje në favor të subjekteve të poshtëshënuar.

Në zbatim të pikës 31 dhe 32 të VKM-së 1040/2020 ku parashikohet që “Lista e subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara, shoqëruar me të dhënat e pasurive, si adresa, zona kadastrale, numri i pasurisë publikohet në ambientet e ASHK-së, pranë njësisë së vetqeverisjes vendore, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ASHK-së” dhe “Subjektet e interesuara në përputhje me afatet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ për vendimin e legalizimit, pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së”, për sa më sipër kërkohet:

- Publikimin për afatin 30 (tridhjetë) ditor në ambientet e Institucionit tuaj së listës së mëposhtme të subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara.
- Çdo subjekt i cili ka pretendim apo ankesë në lidhje me vendimin e legalizimit është i lutur ti drejtohet strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.
- Në përfundim të afatit jeni të lutur të konfirmoni nëse ka apo jo kërkesë/ankesa nga subjektet.

Bashkëngjitur shkresës po ju vemë në dispozicion:

- Tabelën me listën emërore të subjekteve përfituese ku janë të përcaktuara të dhënat e pasurisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

Igll Radomi  
Digitally signed by  
Igll Radomi  
Date: 2024.01.10  
11:27:13 +0200

M. A. Pojan  
ST M P  
12.01.2024

DREJTORI  
Stavri Mushka  
(me urdhër dhe delegim)  
ZV/DREJTORI  
Igll Radomi



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Korçë  
Date: 2024.01.10 10:27:13 +0200  
KORÇË, www.ashk.gov.al, email: info@ashk.gov.al

Nr. 08 Prot



nr. Rendor	Emër	Atësi	Mbiemër	Të dhënat e pasurisë		
1	BEXHET/DITURI	ILIAS/HALIM	HOXHAI	2902	PENDAVINIJ	39/25/1

140878